



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 korrik 2023
Nr. ref.: RK 2238/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI139/22

Parashtrues

Hajredin Canolli

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 510/2021, të 10 majit 2022
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hajredin Canolli, me vendbanim në fshatin Komoran, komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Ibrahim Dobruna, avokat në Drenas.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 510/2021, të 10 majit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [AC. nr. 4282/2017] e 9 marsit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 229/2007] e 6 qeshurit 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimin e kontestuar, parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 16 maj 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Dokumenteve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i të Drejtave të Njeriut], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), me nenin 6.1 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj), nenin 14.1 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejme: PNDKP), dhe nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNj).
5. Parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, kërkon mbajtjen e një seance dëgjimore për t'i qartësuar faktet dhe provat e rastit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-21 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 15 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 22 shtator 2022, Gjykata për regjistrimin e kërkesës njoftoi parashtruesin e kërkesës, nga i cili kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës me dokumentacion relevant. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 22 shtator 2022, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzimin e fletëkthesës si dëshmi e pranimi të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, nga ana e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 26 shtator 2022, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI139/22, caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI139/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).

11. Më 4 tetor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë informoi Gjykatën se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar, më 16 maj 2022.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 25 maj 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës të deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Historiku

14. Kërkesa ka të bëjë me një kontest pronësor, mes parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Prishtinës, përkitazi me paluajtshmërinë nr. 4372/8, e ndodhur në zonën kadastrale të Prishtinës, me një sipërfaqe prej 426 metër katror, për të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon se babai i tij S. Canolli e kishte blerë nga pronari T. Krasniqi, në bazë të një marrëveshjeje gojore atë kohë. Paluajtshmëria në fjalë, e cila ishte pjesë e paluajtshmërisë së ish-pronarit T. Krasniqi është shpronësuar në vitet 70-ta nga Komuna e Prishtinës.

Procedura e shpronësimit

15. Më 7 tetor 1977, Komuna e Prishtinës mori Vendimin 07-nr. 676-65177 për shpronësimin e paluajtshmërisë së lartcekur.
16. Më 23 maj 1978, Drejtoria për tokë ndërtimore, e Komunës së Prishtinës, ia kishte bërë një ofertë T. Krasniqit për shpronësimin e paluajtshmërisë, sipas fletës poseduese nr. 7248, ngastra kadastrale me nr. 4372/1, në sipërfaqe prej 1.11.26 hektarë, në lagjen Arbëria II, në shumë prej 215.517,68 dinarë. Në vërejtje të kësaj oferte është konstatuar se paluajtshmëria e përgjithshme përfshinte sipërfaqen prej 1.18,98 hektarë, ku në emër të truallit nr. 142 ishte refuzuar sipërfaqja prej 0.03,46 hektarë, kurse për truallin nr. 27 ishte refuzuar sipërfaqja prej 0.04,26 hektarë, ndërsa për pagesë ishte vetëm sipërfaqja e vendosur në ofertë. Vendimi përkitazi me shpronësimin e paluajtshmërisë ishte bërë i formës së prerë.
17. Më 7 nëntor 1979, organi përmbarues i administratës së Komunës së Prishtinës, me Aktvendimin nr. 464-65-49/3, kishte kërkuar që shfrytëzuesi i paluajtshmërisë S. Canolli ta lironte paluajtshmërinë në fjalë.
18. Më 15 nëntor 1979, babai i parashtruesit të kërkesës S. Canolli kishte parashtruar ankesë, kundër aktvendimit të lartcekur të organit përmbarues. Megjithatë, meqë vendimi kishte marrë formën e prerë dhe ankesa nuk e kishte ndaluar përmbarimin e aktvendimit në fjalë.
19. Më 22 qershor 1983, Komuna e Prishtinës, nëpërmjet Sekretarit të financave kishte kërkuar asistimin e policisë për të zbatuar aktvendimin e organit përmbarues të Komunës së Prishtinës për lirin e paluajtshmërisë.

Inicimi i padisë në gjykatë

20. Më 14 shkurt 2007, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore kundër Xh. (T) Krasniqi, i padituri i parë dhe Komunës së Prishtinës, e paditura e dytë,

me kërkesë për (i) vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë e lartcekur dhe regjistrimin e së njëjtës në emër të tij, me pretendimin se paluajtshmëria në fjalë ishte blerë nga T. Krasniqi (babai i Xh. Krasniqit), në vitin 1970, në bazë të një marrëveshjeje gojore.

21. Më 17 nëntor 2016, Gjykata Themelore, pas daljes në terren, me ndihmën e ekspertit të gjeodezisë, vërtetoi se kontesti kishte të bënte me ngastrën nr. 4372/8 në rrugën “Azem Jashanica”, ku u vërtetua se kishin nisur punimet për vendosjen e një pllake mbi bazamentin e objektit të banimit, por që punimet ishin ndaluar nga autoritetet e Komunës së Prishtinës. Gjykata vërtetoi se babai i parashtruesit të kërkesës, S. Canolli, e kishte në posedim faktik tërë ngastrën me nr. 4372/8, në sipërfaqe prej 426 metër katror, e cila në librat kadastral evidentohet si pronë në pronësi të Komunës së Prishtinës.
22. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës në seancën përgatitore të mbajtur nga Gjykata Themelore, e kishte tërhequr padinë kundër të paditurit të parë Xh. (T) Krasniqi, dhe e kishte precizuar padinë bazuar në gjetjet e reja të ekspertit të gjeodezisë, duke kërkuar që në vend të ngastrës nr. 4372/1 t’i njihej e drejta e pronësisë në ngastrën nr. 4372/8, në sipërfaqe prej 426 metër katror, mbi bazën e marrëveshjes gojore të shitblerjes dhe të parashkrimit fitues.
23. Më 6 qershor 2017, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [C. nr. 510/2007] nëpërmjet të cilit e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Komunës së Prishtinës, me arsyetimin se paditësi apo paraardhësi i tij e kanë lëshuar afatin për kërkimin e anulimit të vendimit për eksproprijimin, dhe se në rastin konkret nuk është përmbushur as kriteri ligjor i njohjes së të drejtës së pronësisë me anë të parashkrimit fitues.
24. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor, e kishte apeluar Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke kërkuar aprovimin e ankesës dhe njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese.
25. Më 29 mars 2021, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 4283/17, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pathemeltë dhe e konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e Aktgjykimit kjo e fundit, arsyetoi se e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se Aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika (b), (g), (o), (k) dhe (m) e LPK-së, e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.
26. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke u thirrur edhe në shkelje të së drejtës së pronës në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së
27. Më 10 maj 2022, Gjykata Supreme refuzoi si të pathemeltë kërkesën për revizion dhe konfirmoi në tërësi aktgjykimet e instancave më të ulëta. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme, theksoi: “... Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i Aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë

dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e sipërpërmendura, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij, të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Dokumenteve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i të Drejtave të Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, me nenin 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, nenin 14.1 të PNDP dhe nenin 17 të DUDNj-së.

i. Pretendimet për shkelje të së drejtës në “gjykim të drejtë”

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme është në kundërshtim me faktet e vërtetuara dhe me ligjin material të aplikueshëm. Sipas tij, gjykata e shkallës së parë është dashur të veprojë sipas dispozitave të nenit 60 të Ligjit mbi ekspropriimin, për zgjidhjen çështjes së tij. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“përmes dëgjimit të të paditurit Xh. T. Krasniqi, ... në cilësi të dëshmitarit ka provuar se paditësi është pronar i kësaj paluajtshmërie, e cila është provë valide dhe e njëjta nuk është zgjidhur nga palët kontraktuese e as nga ana e organit kompetent - gjykata, dhe si e tillë prodhon efekte juridike në mbështetje legjitime të kërkesës së paditësit. Kjo deklaratë gjen mbështetje edhe në Ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, hartuar sipas angazhimit të gjykatës nga Q. H, gjeometër, me shenjë C. nr. 229/07 dt. 20.02.2017. Konstatimin e mësipërm, e provon edhe vetë gjykata, kur analizon provën e lexuar si fleta poseduese dhe të aktvendimit të shpronësimit, se është evidentuar emri Canolli Salih, sip. 0.15.00 ha (delo plac hr. 27 S-4.26 ha)”.*
30. Parashtruesi i kërkesës në këtë drejtim thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar dhe arsyetuar faktet vendimtare që ndërlidhen me sipërfaqen e blerë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ari, nga e cila 3.92 të sipërfaqes i posedon dhe shfrytëzon ai, 4.24 i posedon dhe shfrytëzon N. Canolli, ndërsa 2.00 të tjerë janë shpronësuar për ndërtimin e rrugës. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës thekson se sipërfaqja prej 10,16 ari është juridikisht dhe faktikisht e qartë, por sipërfaqes së përgjithshme prej 15 ari, kur i zbriten 10.16 ari, mbetet sipërfaqja prej 4,84 ari, e cila sipas tij është pikërisht kjo sipërfaqe që është konstatuar nga ekspertiza e gjykatës [NK. nr. 4372-8], për të cilën pretendon se i takon atij.
31. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“... paditësi e as i autorizuari i tij, nuk mund të pajtohen me përfundimin apo qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, sepse i njëjti nuk është i bazuar në ligj dhe se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika i, n), neni 182.1 në lidhje me nenin 2, nenin 160.4 dhe 160.5 të LPK-së, për çfarë edhe aktvendimi refuzues nuk mund të qëndrojë. (...). Nxjerrja ndryshe e përfundimeve të gjykatës nga provat e prezantuara, e bënë kontradiktor arsyetimin me provat e administruara dhe ligjin material, të cituara më sipër. Pra kemi të bëjmë me mungesë trajtimi të kërkesëpadisë, në dimensionin e të provuarit të fakteve të pretenduara nga paditësi, përmes administrimit të gjithmbarshëm e gjithëpërfshirës të provave materiale dhe personale. Gjykata e shkallës së parë duke mos shqyrtuar ligjin në tërësi, duke mos e rishikuar lëndën me kujdes, duke mos marrë parasysh provat e qarta të prezantuara nga ana e paditësit, dhe përfundimisht duke bërë*

qartësisht shkelje procedurale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ka vendosur në këtë çështje kundërligjshëm”.

32. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se, *“Gjykata e shkallës së dytë, duke përcjellur po të njëjtin model të gabimeve thelbësore, duke mos i shqyrtuar provat me kujdes, dhe duke mos e shqyrtuar ligjin në tërësi, por vetëm duke vendosur ashtu siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me të drejtën dhe me shkelje thelbësore procedurale e materiale, i pamundëson paditësit të ushtrojnë të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm”.*
33. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se, *“Gjykata Supreme ndërkaq, ka refuzuar revizionin, Aktgjykim ky i cili nuk do të merrej fare po që se shkalla e parë apo ajo e dytë do të merrte vendim meritore në lidhje me padinë e parashtruar nga ana e paditësit - tani parashtruesve të kërkesës. Me këtë, ajo ka bërë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila i garanton qytetarëve gjykim të paanshëm dhe të drejtë. Në këtë rast, paditësve nuk i është mundësuar ushtrimi i kësaj të drejte themelore i mbajtes së gjykimit të drejtë dhe të barabartë”.*
34. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 510/2021 dt. 10.05.2022 dhe Gjykatës së Apelit Ac. nr. 4283/17 të datës 09 mars 2021, duke përfshirë edhe atë të gjykatës së shkallës së parë C. nr. 229/07, datë 06.06.2017, kanë të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjykimeve është kontradiktor me vetveten e me arsyet e aktvendimeve. Në të nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë, të njëjtat janë shumë të paqarta dhe ato pak arsye të dhëna janë në kundërshtim me parashtruesat, faktet, si dhe provat e kësaj çështjeje. Andaj, Gjykata në këtë mënyrë në procedurë, me veprimet e saja, ka bërë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, veçmas ka shkelje të dispozitave të nenit 182.2. pika n) të LPK-së”.*

ii. Pretendimet për shkelje të së “drejtës së pronës”

35. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim thekson se, sipas kuptimit të nenit 46 të Kushtetutës, baza e parë e shpronësimit është përshtatja e saj me ligjin; e dyta është domosdoshmëria apo mënyra adekuate e formës së përmendur e kufizimit të së drejtës së pasurisë; e treta është arritja e qëllimeve publike apo përkrahja e interesit të përgjithshëm; dhe se kufizimi i të drejtës së pasurisë, d.m.th, shpronësimi lejohet vetëm me kusht që kjo të bëhet me kompensim të drejtë ndaj personit apo personave pasuria e të cilëve konfiskohet. Në këndvështrimin e parashtruesit të kërkesës, *“Kushtetuta e përcakton shprehimisht që ky kompensim duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe kompensim adekuat, që do të thotë se nuk mund të jetë më i ulët se vlera e tregut. Rrjedhimisht, në interpretimin e paragrafit 3, të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rezulton se për shkak të moszbatimit të Ligjit për Eksproprijimin, paditësi, këtu kërkuesi, është privuar në mënyrë arbitrare nga prona”.*
36. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se, *“Konfuzioni, pasaktësia, mungesa e arsytimit dhe përgjigjeve në pyetjet e ngritura, e bëjnë këtë proces të gjykatave të rregullat jo të bazuar në ligjin procedural dhe material, rrjedhimisht dhe aktgjykimi që ka derivuar nga këto mangësi dhe të meta, këtë proces e bën arbitrar dhe privim të paditësit –kërkuesit nga të drejtat e pasurisë, të garantuara me dispozitat e sipërcituara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 46), Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 17), dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1”.*
37. Përveç pretendimeve të mësipërme, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 22, 53 dhe 54 të Kushtetutës.

38. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë të pranueshme kërkesën, të konstatojë se aktgjykimet e Gjykatës Themelore, të Apelit dhe të asaj Supreme, shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenet 22, 46 dhe 53 të Kushtetutës, dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, si dhe nenin 14.1 të PNDCP-së, si dhe nenin 17 të DUDNj-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Neni 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Protokollit nr. 1 i KEDNj-së

Neni 1

[Mbrojtja e Pronës]

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike (PNDKP)

Neni 14

1. Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile. Shtypi dhe publiku mund të largohen gjatë gjithë procesit ose të një pjese të tij, qoftë kur e kërkon interesi i sjelljes së moralshme, i rendit publik ose i sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur e kërkon interesi i jetës private të palëve, qoftë edhe kur gjykata e quan krejtësisht të domosdoshme në qoftë se, për disa rrethana të veçanta të çështjes, publiciteti mund të dëmtonte interesat e drejtësisë; megjithatë çdo gjykim i dhënë në çështjen penale ose civile do të jetë publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve kërkon ndryshe ose në qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e fëmijëve.

Deklarata e Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj)

Neni 17

- 1. Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët.*
- 2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.*

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

41. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

42. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 510/2021], e 10 majit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
43. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

44. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së Trofimchuk kundër Ukrainës, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu Baillard kundër Francës, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, Kemmache kundër Francës, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), Juta Mentzen kundër Lituaniës, nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).
45. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, sikundër dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe i Gjykatës së Apelit, shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenet 22, 31, 46, 53 dhe 54 të Kushtetutës, me nenin 6.1 të KEDNj-së, nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, nenin 14.1 të PNDKP-së dhe nenin 17 të DUDNj-së.
46. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve që ngërthen kërkesa e parashtruesit të kërkesës, ndërlidhet me shkeljen e së drejtës në “gjykim të drejtë”, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, dhe me shkeljen e të drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.
47. Andaj, në vlerësimin e këtyre dy pretendimeve kryesore, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së

48. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me faktin se gjykatat e rregullta në mënyrë të gabuar kanë vërtetuar faktet e rastit dhe në mënyrë të gabuar kanë aplikuar ligjin material dhe procedural, kur kanë vendosur në lidhje me kërkesën për vërtetimin e të drejtës së pronësisë. Në të vërtetë i gjithë arsyetimi i shkeljes së të drejtës për “gjykim të drejtë” është ndërtuar në kuadër të pretendimeve të “shkallës së katërt”, andaj në vazhdim Gjykata do i shtjellojë parimet e përgjithshme, të përcaktuara nëpërmjet praktikës së GJEDNj-së dhe të praktikës së Gjykatës.

a) Parimet e përgjithshme përkitazi me pretendimet e “shkallës së katërt”

49. Gjykata përsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNj-së, [*Garcia Ruiz kundër Spanjës*](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999). Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi/ja të ketë pasur gjykim të drejtë (shih rastin e GJEDNj-së, [*Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#), nr. 13071/87; dhe rastin e Gjykatës [*KI192/13*](#), me parashtrues *Hatixhe Avdyli*, Aktvendimi i 24 shkurtit 2014).

50. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose ligjshmërisë që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ato i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt”, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Çështjet që lidhen me vlerësimin e provave dhe peshimin e tyre nga ana e gjykatave vendore, nuk janë në kompetencën e Gjykatës të rishikohen (shih rastin e GJEDNj-së, [*Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*](#), Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016; dhe rastin e Gjykatës [*KI70/11*](#), me parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima*, Aktvendimi i 12 dhjetorit 2011).

51. Gjykata, megjithatë, thekson se jurisprudenca e GJEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNj-së, [*Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*](#), Aktgjykimi i 25 majit 2000.).

52. Në parim, një përjashtim i tillë ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”, në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*”, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë “qartazi të gabuar”, në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës.

53. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcakton që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të

garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GjEDNj-së, *Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; rastin e Gjykatës *KI96/21*, parashtrues *Xhelal Zherka*, Aktvendim i 10 shtatorit 2021).

54. Gjykata, si rregull të përgjithshëm, ka theksuar që nuk mund të vë në dyshim gjetjet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; apo edhe (v) fajin ose pafajësinë e të akuzuarit në procedurën penale.
55. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua edhe më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih rastin e GjEDNj-së, *Miraqall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000; rastin e Gjykatës *KI179/18*, me parashtruesen *Belgjyzar Latifi*, Aktvendimi i 24 qershorit 2020).
56. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e Gjykatës *KI49/19*, me parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendimi i 10 shtatorit 2019).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

57. Referuar pretendimit thelbësor në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë, Gjykata vëren se argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës është se "*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 510/2021 dt. 10.05.2022 dhe Gjykatës së Apelit Ac. nr. 4283/17 të datës 09 mars 2021, duke përfshirë edhe atë të gjykatës së shkallës së parë C. nr. 229/07, datë 06.06.2017, kanë të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjyqimeve është kontradiktor me vetveten e me arsyet e aktvendimeve. Në të nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë, të njëjtat janë shumë të paqarta dhe ato pak arsye të dhëna janë në kundërshtim me parashtruesat, faktet, si dhe provat e kësaj çështjeje. Andaj, Gjykata në këtë mënyrë në procedurë, me veprimet e saja, ka bërë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, veçmas ka shkelje të dispozitave të nenit 182.2. pika n) të LPK-së".*
58. Në lidhje me këtë pretendim, dhe shikuar procedurat në tërësinë e tyre, në kuptim të rregullsisë së procesit, Gjykata fillimisht i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi: "*... paluajtshmëria lëndore është ekspropriuar, andaj në rastin konkret nuk ekziston mirëbesimi i posedimit, ashtu siç parashihet në dispozitën e nenit 72, par. 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, ku thuhet se "Posedimi është me mirëbesim po që se mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi që e mban nuk është i tij".*
59. Tutje, Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj theksoi se: "*Sipas dispozitës së nenit 21, al. 5 të Ligjit mbi Eksproprijimin të KSAK-së, pasi që të kalojnë 10 vite nga dita kur vendimi mbi eksproprijimin të merr formë të prerë, nuk mund të paraqitet kërkesë për anulimin e këtij vendimi, pra në rastin konkret vendimi mbi eksproprijimin është marrë me dt. 07.10.1977, kurse personi që deri atëherë ishte i regjistruar si pronar nuk kishte parashtruar ankesë. Paditësi nuk ofroi prova se aktvendimin mbi eksproprijimin e kishte ankuar as në afatin objektiv - para se të kalojnë 10 vite nga*

marrja e aktvendimit, deri në paraqitjen e padisë pranë gjykatës me dt.14.02.2007, ku me këtë rast kishin kaluar më se 30 vite nga marrja e aktvendimit mbi eksproprijimin. Në rastin konkret, del se paditësi apo paraardhësi i tij, kanë lëshuar afatin për kërkimin e anulimit të vendimit për eksproprijim prandaj gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar”.

60. *Gjykata Themelore erdhi në përfundim se “... paditësi e ka humbur të drejtën e pronësisë në momentin kur prona e tij, gjegjësisht e paraardhësit të tij S. Canolli, ka kaluar në pronësi shoqërore, në pajtim me dispozitën e nenit 44 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore LMTHJP, ku përcaktohet se e drejta pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësi shoqërore. Duke theksuar faktin se gjykata në tërësi pranon konceptin se prona duhet të mbrohet sipas protokollit 1 një të Konventës Evropiane, meqë mbrojtja e pronës sipas kësaj konvente për gjykatën është detyrim kushtetues, mirëpo, në rastin konkret, vlerësimi i gjykatës është se kërkesëpadia është e pabazuar, pasi që gjykata në asnjë rast nuk mund të thirret në mbrojtje të pronës së një subjekti, duke mohuar të drejtën e ligjshme të subjektit tjetër”.*
61. *Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e kishte apeluar Aktgjykimin e lartcekur në Gjykatën e Apelit, duke aluduar në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, në shkelje të ligjit material dhe procedural. Kjo e fundit, në Aktgjykimin e saj, arsyetoi: “Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika (b), (g), (o), (k) dhe (m) e LPK –së, e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së”.*
62. *Përkitazi me pretendimin për shkelje procedurale, Gjykata e Apelit: “e ka vlerësuar si të pathemeltë pretendimin ankimor të autorizuarit të paditësit për shkelje të dispozitave procedurale nga neni 182, par.2, pika n), me vlerësim se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin si dhe janë paraqitur arsye të qarta për faktet vendimtare e që ndërlidhen me kërkesën e palës për vërtetimin e së drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese. Gjykata duke vepruar sipas kërkesës së palës paditëse ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me vërtetimin e së drejtës së pronësisë në ngastrën kontestuese e cila mbi bazën e eksproprijimit ka kaluar te e paditura në procedurë të rregullt.*
63. *Përkitazi me pretendimin për vërtetim të gabuar të fakteve, Gjykata e Apelit, konsideroi se: “Pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe të plotë të gjendjes faktike shihet se i referohen çështjes së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, përkatësisht mos pranimit të pagesës në emër të kompensimit, mirëpo një pretendim i tillë nuk ka ndikim marrë për bazë kërkesën e palës paditëse që ka të bëjë me vërtetimin e të drejtës së pronës dhe jo kompensim të paluajtshmërisë së eksproprijuar. Në rrethana të tilla, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me kërkesën e palës për vërtetim pronësie dhe mbi këtë bazë, ka aplikuar drejtë dispozitat materiale që e rregullojnë çështjen e fitimit të së drejtës së pronësisë në paluajtshmëri”. Gjykata me aktvendimin për eksproprijim 07-nr.676-65177, të 7 tetorit 1977, procedurën e ekzekutimit të këtij vendimi, deklarimin e paraardhësit të paditësit në procesverbalin numër 07-646-65177, të 19 shtatorit 1977, ka vërtetuar faktin se paluajtshmëria kontestuese është eksproprijuar sipas vendimit të formës së prerë dhe ka kaluar, përkatësisht është regjistruar në emër të paditurës-evidentohet si pronë shoqërore. Gjykata ka vërtetuar se paraardhësi i paditësit ka qenë në dijeni të procesit të eksproprijimit dhe ajo çfarë rezulton nga procesverbali i sipërtheksuar ai nuk është pajtuar me kompensimin që është ofruar për shpronësim, mirëpo në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka nevojë që të vërtetojë se i njëjti është kompensuar*

ngase prej palës paditëse nuk ka pasur kërkesë për kompensim por për vërtetim të së drejtës së pronësisë.

64. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se e drejta e pronësisë është fituar me “parashkrim fitues”, Gjykata e Apelit, arsyetoi: *“Në rrethana të tilla, Gjykata e Apelit vlerëson se paditësi nuk mund ta fitojë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese as sipas bazës së parashkrimit fitues nga neni 28 i LMTHPJ-së, kjo pasi që paluajtshmëria ka kaluar në emër të paditurës, sipas bazës së ligjshme-ekspropriimit, paditësit apo paraardhësit e tij kanë qenë në dijeni për këtë proces, ku edhe nuk janë pajtuar me çmimin e ofruar, kështu që paditësi e ka ditur dhe është dashur të dijë se kjo paluajtshmëri nuk është e tij, kështu që në asnjë rrethanë nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozitat e këtij neni për fitimin e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues”.*
65. Në vazhden e pretendimeve për parregullsi të procesit, Gjykata i referohet po ashtu Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, arsyetoi: *“Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se e drejta e pronësisë është fituar me “parashkrim fitues”, ... Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me refuzimin e kërkesës së paditësit, pasi që janë dhënë arsyet bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Kështu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga provat e administruara, nuk mund të konkludohet se paditësi është pronar i paluajtshmërisë kontestuese, të specifikuar në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ngase me asnjë bazë juridike nuk ka provuar pronësinë e paluajtshmërisë kontestuese, për të cilat ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar, siç parashihet me dispozitën e nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, sipas së cilës është paraparë se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik (punës juridike), dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe nen kushtet e përcaktuara me ligj”.*
66. Në përfundim, Gjykata Supreme, arsyetoi se në kontestet civile kur kërkohet mbrojtja gjyqësore e pronës, që ndërlidhet me vërtetimin e pronësisë mbi pronën përkatëse, si dhe dorëzimin e sendit/kthimin e paluajtshmërisë në posedim: *“paditësi, sipas nenit 37 të ligjit të sipërpërmendur, duhet të provojë që është pronar i sendit, me të cilin nënkuptohet edhe vërtetimi i fakteve, mbi të cilat bazohet e drejta e tij, dhe atë jo vetëm ndaj paditësit, por edhe ndaj paraardhësve të tij. Paditësi është i detyruar të provojnë ekzistimin e fakteve juridike në bazë të së cilave fitohet apo në bazë të së cilave mund të fitohet e drejta e kërkuar e pronës. Gjë që, në rastin konkret civil - juridik, paditësi nuk e ka provuar, as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus-modus aquirendi) të paluajtshmërisë kontestuese, të sipërpërmendur. Në kontekstin e mësipërm, paditësi nuk ka provuar se e ka fituar pronësinë në bazë të parashkrimit fitues (Usucapio), përkatësisht, sikundër ka pretenduar, se me mbajtje dhe posedim me mirëbesim mbi 20 vite e ka fituar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese. Dhe kur jemi këtu, duhet theksuar se posedimi është me mirëbesim në qoftë se mbajtësi nuk din ose nuk mund ta dijë se sendi që e mban nuk është i tij (neni 72 i LMTHPJ-së). Në rastin konkret, fakti relevant është se paditësi, respektivisht, edhe paraardhësi i tij, e kanë ditur se paluajtshmëria kontestuese është ekspropriuar nga e paditura e dytë, në vitin 1977, e në llogari të këtij fakti, veç tjerash, flet edhe procesverbali nr.07-464-65/77 -49 dt.19.09.1977, i cili gjendet në shkresat e lëndës, në të cilin, vet paraardhësi i paditësit S. Canolli ka deklaruar se pajtohet me ekspropriimin e paluajtshmërisë kontestuese, d.m.th kalimin e saj në emër të së paditurës dhe regjistrimin si pronësi shoqërore, ndërsa, ka kërkuar kompensimin përkatës, ndaj, nga këtu, përkitazi me pretendimin e paditësit, nuk mund të bëhet fjalë për posedimin me mirëbesim e me këtë as për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, sikundër parashihet me dispozitën e nenit 28.4 të Ligjit të sipërpërmendur, sipas të cilës, përveç posedimit të*

sendit dhe kohëzgjatjes së posedimit prej 20 viteve, kërkohet që posedimi të jetë edhe me mirëbesim, gjë që, siç u sipërtheksua, këtu nuk është rasti”.

67. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në prova të administruara, siç janë listuar në detaje në Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, Gjykata vlerëson që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar të rëndësishme për rastin e tij, se atij i është dhënë mundësia që t'i kundërshtojë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare. Në këtë kontest, gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet e tij, të ngritura në padi, ankesë dhe kërkesë për revizion, si sa i përket fakteve vendimtare po ashtu dhe bazës juridike të aplikuar.
68. Gjykata rithekson se ajo vetë nuk lëshohet në vlerësimin e provave, siç janë kontratat, ekspertizat dhe të tjerat, e as në përcaktimin e rëndësisë së tyre gjatë procesit gjyqësor. Nga citimet e mësipërme të gjykatave të rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, Gjykata vlerëson se vendimet e tyre përmbajnë arsyetime të mjaftueshme në lidhje me vlerësimin e fakteve dhe të provave, që kanë çuar deri në një vendimmarrje të caktuar.
69. Gjykata konsideron që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta mbështes mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sepse bazuar në parimet e përcaktuara, në rastin konkret nuk është përmbushur kriteri përjashtues, kur interpretimi i ligjit të aplikueshëm nga ana e gjykatave të rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar kështu në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të kenë qenë të padrejta apo arbitrare. (shih *mutatis mutandis*, rastin GJEDNJ-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimin e 21 janarit 1999, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42). Shih rastet e Gjykatës [KI64/20](#), parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI22/19](#), cituar më lart, paragrafi 43).
70. Andaj, nga të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konsideron se pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përkitazi me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe të provave, dhe interpretimin e gabuar të ligjit, përkojnë me kategorinë e parë (i) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime të “shkallës së katërt”, andaj, si të tilla të njëjtat në baza kushtetuese janë qartazi të papabazura.

ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me shkeljen e “të drejtës së pronës”

a) Parimet e përgjithshme

71. Gjykata rikujton se mbrojtja e pronës është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari thekson se paragrafi 1 i nenit 46 të Kushtetutës e garanton të drejtën e pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik dhe paragrafi 3 i nenit 46 të Kushtetutës garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet në të cilat prona mund të shpronësohet (shih, ngjashëm, rastet e Gjykatës, [KI50/16](#), me parashtrues: *Veli Berisha dhe të tjerët*, Aktvendimi i 10 marsit 2017, paragrafi 31 dhe [KI82/20](#), me parashtrues *Jakup*

- Mehmeti*, Aktvendimi i 25 majit 2021, paragrafi 72). Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, Gjykata rithekson se ky nen përbëhet nga tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura: rregulli i parë shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshton atë kushteve të caktuara; dhe, rregulli i tretë, ua njeh të drejtën shteteve që të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i çmojnë si të nevojshme për arritjen e një qëllimi (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNj-së: *Sporrong dhe Lonrot kundër Suedisë*, nr. 7151/75; 7152/75, Aktgjykimi i 23 shtatorit 1982, paragrafi 61; *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2012; *Sargsyan kundër Azerbaixhanit*, nr. 40167/06, Aktgjykimi i 16 qershorit 2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, Aktgjykimi i 13 dhjetorit 2016).
72. Gjykata rikujton se të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptimin e të qenët të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNj-së rasti *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, Aktgjykimi i 21 shkurtit 1986, paragrafi 37).
73. Sa i përket rregullit të parë, GJEDNj vazhdimisht ka konstatuar se koncepti i “pasurisë” i cili bën pjesë në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së është një koncept autonom, që përfshin si “pasuritë ekzistuese” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “prishmëri legjitime”. “Pasuritë” sipas këtij koncepti përfshijnë të drejtat “*in rem*” dhe “*in personam*”, siç është pasuria e paluajtshme, e luajtshme dhe interesat e tjera pronësore.
74. Koncepti autonom i “pasurisë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së është i pavarur nga klasifikimi thjesht formal në ligjin vendor dhe nuk është i kufizuar në pronësinë e të mirave fizike: disa të drejta dhe interesa të tjera që përbëjnë “asete” mund të konsiderohen gjithashtu si “të drejta pronësore”, dhe kështu si “pasuri” për qëllimet e kësaj dispozite. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast veç e veç është nëse rrethanat e rastit, të marra si një tërësi, i janë dhënë parashtruesit të kërkesës si një e drejtë me interes thelbësor të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNj-së (shih, *Depalle kundër Francës*, [DHM], nr. 34044/02, Aktgjykimi i 29 marsit 2010, paragrafi 62; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, [DHM], nr. 73049/01, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, paragrafi 63; *Öneryıldız kundër Turqisë*, [DHM], nr. 48939/99, Aktgjykimi i 30 nëntorit 2004, paragrafi 124; *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], nr. 31443/96, Aktgjykimi i 28 shtatorit 2005, paragrafi 129; *Beyleer kundër Italisë*, [DHM], nr. 33202/96, Aktgjykimi i 5 janarit 2000, paragrafi 100; *Iatridis kundër Greqisë*, [DHM], nr. 31107/96, Aktgjykimi i 19 tetorit 2000, paragrafi 54; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano kundër Italisë*, [DHM], nr. 38433/09, Aktgjykimi i 7 qershorit 2012, paragrafi 171; *Fabris kundër Francës*, [DHM], nr. 16574/08, Aktgjykimi i 7 shkurtit 2013, paragrafi 49 dhe 51; *Parrillo kundër Italisë*, [DHM], nr. 464770/11, Aktgjykimi i 27 gushtit 2015, paragrafi 211; *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, [DHM], nr. 53080/13, Aktgjykimi i 13 dhjetorit 2016, paragrafi 76).
75. Koncepti i “pasurisë” dhe i “prishmërisë legjitime” kanë një vend qendror në interpretimin e të drejtave pronësore të garantuara me KEDNj dhe të zhvilluara më tej me praktikën gjyqësore të GJEDNj-së. Nga ana tjetër, “prishmërit legjitime mund të rezultojnë në pasuri”. Edhe pse neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNj-së zbatohet vetëm për pasurinë ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës, në rrethana të caktuara, një “prishmëri legjitime” për fitimin e një prone mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1

të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 73 dhe 75, dhe *Broniowski kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 129).

76. Në mënyrë që një “pritshmëri” të jetë “legjitime”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa thjesht një shpresë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt juridik siç është një vendim gjyqësor, që paraqet një interes të pronës në fjalë (shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, nr. 44912/98, Aktgjykimi i 28 shtatorit 2004, paragrafët 49-50; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 173; *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 103; *Ceni kundër Italisë*, paragrafi 39; dhe *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 75). Në të kundërtën, asnjë “pritje legjitime” nuk mund të thuhet se lind, kur ka një mosmarrëveshje sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të ligjit vendor dhe kur kërkesat e parashtruesve më pas refuzohen nga gjykatat kombëtare (shih, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 65; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 173; *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 75; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë*, [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, Aktgjykimi i 20 marsit 2018, paragrafi 149).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

77. Fillimisht, Gjykata rikujton se ajo i konsideroi qartazi të pabazuara pretendimet e parashtruesit për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë” të cilat ndërlidheshin me vërtetimin të gabuar të fakteve dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm.

78. Referuar, pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së pronës, Gjykata vëren se argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me çështjen se deri të shkelja e nenit 46.3 të Kushtetutës ka ardhur “për shkak të moszbatimit të Ligjit për Eksproprijimin, paditësi, këtu kërkuesi, është privuar në mënyrë arbitrare nga prona.”

79. Megjithatë Gjykata, duke u bazuar në parimet e përgjithshme përkritazi me të drejtat e pronës/pasurisë, në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, pasi analizoi rrethanat e rastit konkret, vlerëson se parimet e lartcekura nuk janë të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës, për arsye se të gjitha pretendimet e tij në lidhje me vërtetimin dhe njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese, janë refuzuar si të pabazuara nga të gjitha instancat gjyqësore nga arsyet siç janë shtjelluar sa më sipër.

80. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore të fituar me një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe as me një të drejtë të pohueshme, të fitimit të së drejtës së pronësisë me ligj. Për më tepër, të gjitha kërkesat e parashtruesit të kërkesës për njohje të së drejtës së pronësisë ishin të pasuksesshme (shih, ngjashëm, GjEDNJ rasti *Kopecký kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 52). Në këtë rrethanë, parashtruesi i kërkesës nuk mund të pretendojë shkelje të të drejtave të tij pronësore, përderisa gjykatat e rregullta nuk ia miratuan kërkesëpadinë për vërtetimin dhe njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese (shih, ngjashëm rastin e Gjykatës [KI82/20](#), cituar më lart, paragrafi 82).

81. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se ajo vetë nuk mund të shndërrohet në gjykatë të faktit, dhe të vërtetojë të drejtën e pronësisë ose të rikthejë në posedim faktik dhe juridik një pronë të caktuar, sepse një kompetencë e tillë, si rregull, u takon gjykatave të rregullta që ta bëjnë. Për më tepër, Gjykata përjashtimisht mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur parashtruesve të kërkesave u është “njohur” e drejta e pronësisë së një prone të caktuar me një “vendim gjyqësor përfundimtar” ose me “ligj” dhe kur një e

drejtë e fituar nuk ka gjetur zbatim në praktikë ose kur gëzimi paqësor i pronës (pasurisë) është penguar dhe pamundësuar nga individët apo autoritetet përkatëse në mënyrë të jashtëligjshme (shih, rastin e Gjykatës [KI82/20](#), cituar më lart, paragrafi 83).

82. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e “të drejtës së pronës” është qartazi i pabazuar dhe si i tillë kualifikohet në kategorinë e dytë (ii) të pretendimeve me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*.

iii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet e tjera

83. Në vlerësimin e pretendimeve tjera, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 17 të DUDNj-së është shteruar tashmë sepse i njëjti është adresuar në kuadër të pretendimeve të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së. Ndërsa sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 22, 53 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç faktit se i është referuar këtyre neneve, nuk tregon dhe shtjellon tutje se si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e tyre nga autoritetet publike a gjykatat e rregullta.
84. Gjykata përsërit se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNj, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) cituar më lart, paragrafi 52; [KIO4/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
85. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, në baza kushtetuese duhet deklaruar qartazi të pabazuara.

Kërkesa për seancë dëgjimore

86. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore me pretendimin se: *“Një seancë e tillë do të kishte rëndësi të posaçme meqenëse do t’u ofronte palëve mundësinë për të shpjeguar tutje çështjen në trajtim si dhe për t’u përgjigjur në pyetjet e mundshme që do të ndikonin në marrjen e një vendimi të drejte.”* Gjykata rikujton se rregulli 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] paragrafi (2) i Rregullores së punës përcakton që *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit”*.
87. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ky rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese [KI34/17](#), parashtruese *Valdete Daka*, vendimi i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 dhe rastin [KI175/20](#) parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafët 85-86, ku thuhet se *“Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast...”*).

88. Gjykata, sapo konstatoi se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesë për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, janë qartazi të pabazuara, andaj në dritën e kësaj nuk e konsideron të nevojshme të mbajë seance dëgjimore, pasi që dokumentet e bashkëngjitura në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

Përfundime

89. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon: (I) pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtës në “grykim të drejtë”, i përkasin kategorisë së parë (i) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime të “shkallës së katërt”, të cilat si të tilla në baza kushtetuese shpallen qartazi të pabazuara; (II) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së “drejtës së pronës”, si i tillë kualifikohet në kategorinë e dytë (ii) të pretendimeve që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes; dhe (III) pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese, i takojnë kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë a), të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, andaj edhe këto në baza kushtetuese, shpallen qartazi të pabazuara.
90. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të shpallet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 25 maj 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, kërkesën për mbajtën e seancës dëgjimore;
- III. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani